3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MJEDISIT

Nr. 5742 Prot. Lushnjë 16/06/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
(këtu)

"PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT: REHABILITIMI I KANALIT TË UJËRAVE TË LARTA (POZICIONUAR NË SEGMENTE TË NDRYSHME) DHE NDËRTIMI I MURIT MBAJTËS (ME PILOTA) NË RRUGËN "VËLLEZËRIT FRASHËRI""

Të nderuar këshilltare/ këshilltarë

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës urbane (rrjet kanalizimesh, rrrugë trotuare, gjelbërim, ndriçim etj,) parashikohet ndërhyrja në Kanalin e Ujërave të Larta. Kjo ndërhyrje shoqërohet me ndërtim veprash arti (mure mbajtës, mure me pilota, rrugë e trotuare për këmbësorë. Kjo ndërhyrje është në vazhdim të investimit të kryer më parë.

A. Ndërhyrja në Kanalin e Ujërave të Larta parashikohet të kryhet në segmentet e mëposhtme.

1. Segmenti nga rezervuari – rruga Vasil Prifti me një gjatësi 312 ml. Ndodhet në lagjen Kongresi, Njësia Administrative nr. 2, dhe ka një shtrirje përdhatë vijës së relievit kodrinor.. Ka dëmtime të betonit ekzistues, shkarje për të cilat nevojiten ndërtimi i mureve mbajtës. Paralel me këtë kanal anga ana perëndimore është parashkuar dhe ndërtimi i një pedonale i shoqëruar edhe me ndriçim për ta kthyer në një zonë rekreative.
2. Segmenti nga rruga Vasil Prifti deri në rrugën Naun Tesho me një gjatësi 426 ml. Ndodhet në lagjen Xhevdet Nepravishta, Njësia Administrative nr. 2. dhe ka një shtrirje përdhatë vijës së relievit kodrinor. Në këtë segment është kryer ndërhyrje para disa vitesh por është e nevojshme të kryhet pastrimi dhe riparime të pjeshme në ato vende ku ka dëmtime.
3. Segmenti përgjatë zjarrëfikëses me një gjatësi 22 ml. Ndodhet në lagjen Xhevdet Nepravishta, Njësia Administrative nr. 2. dhe ka një shtrirje përdhatë vijës së relievit kodrinor dhe lidh pjesën ku kanali është me seksion betoni me pjesën ku kanali është mbyllur me bokse 2 x 2m. Ndërhyrja parashikon gërmim, pastrim, seksionim me beton sipas profilit të hartuar.
4. Sementi përgjatë rrugës Iljaz Ahmeti me një gjatësi 143 ml. Ndodhet në lagjen Xhevdet Nepravishta, Njësia Administrative nr. 2. Ky segment shtrihet në një terren fushor përgjatë vijës natyrore të kullimit të ujërave që vijnë nga zona e kodrës në drejtimin perëndimor.

5. Segmenti përgjatë rrugës Arif Kurti me një gjatësi 840 ml. . Ndodhet në lagjen Gafurr Muço, Njësia Administrative nr. 4. Dhe ky segment shtrihet në një terren fushor përgjatë vijës natyrore të kullimit të ujërave që vijnë nga rruga Iljaz Ahmeti dhe shkojnë në drejtim të autostradës.

B. Rruga, "Vëllezërit Frashëri "

Kjo urgjencë e bën më të domosdoshme për faktin se në këtë rrugë është shfaqur fenomeni i rrëshqitjes dhe rruga ka pësuar dëmtime të dukshme, të cilat rrezikojnë banesat që ndodhen në këtë rrugë dhe përdoruesit e rrugës.

Rruga "Vëllezërit Frashëri" ndodhet në lagjen "Kongresi I Lushnjës". Ajo ka një gjatësi 77 ml .Rruga është në një terren të pjerrët. Në anën e majtë të rrugës banesat ndodhen nën nivelin e rrugës me një disnivel që varion nga 3 deri në 6 m. Në anën e djathtë banesat janë mbi nivelin e rruges në kuotat 2-3 m nga niveli i rrugës. Gjerësia e rrugës është 3.5 deri në 4.5 m. Banesat në dy anët e rrugës janë 2-3 kate dhe të ndertuara reth viteve 1990-1992. Gjatë ndërtimit të banesave janë bërë zbankime të dherave në kodër për të krijuar sheshe ndërtimi. Ka qenë e domosdoshme që të kryheshin punime për sistemimin e ujërave , për mbrojtjen e skarpateve të krijuara. Këto punime kanë munguar, janë kryer nga vet banorët disa mure mbajtëse. Të ndertuar jo profesionalisht nuk kanë realizuar mbrojtjen e nevojshme. Gjatë ketyre viteve,në një segment në gjatësi prej 40 m rruga ka pësuar plasaritje të cilat kohët e fundit kanë avancuar duke krijuar çarje deri në 0.5 m. dhe janë rrezik për banesat që ndodhen në këtë rrugë. Pervec rrezikut qe ka për banesat, plasaritjet në rrugë kanë bërë që pjesa e kalushme në rrugë të jetë deri në 2.5 m.
Projekti i hartuar propozon marrjen e masave inxhinjerike për përmirësimin e gjendjes së krijuar si dhe për të realizuar mbrojtjen e rrugës nga rreshqitja.
Projekti propozon struktura mbajtëse pilota betonarme për rrugën . Sipas disnivelit do të përdoren 2 tipe pilotash të tipit 1 me gjatësi 7 m dhe të tipit 2 me gjatësi 8 m.
Rruga do të asfaltohet duke i ndryshuar pjerrësinë në seksionin tërthor të saj në drejtim të kodrës.

Për të sistemuar kullimin e ujërave të shiut në anën e brendshme të rrugës është parashikuar një kunetë betoni për mbledhjen e ujërave.

Ndërhyrja është dhe si kërkesë e qytetarëve të lushnjës në dëgjesat e buxhetit të vitit 2026 të zhvilluara gjatë muajit nëntor 2025.

Kjo ndërhyrje parashikohet të financohet nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore miratuar me VKM Nr. 384, datë 28/05/2026 dhe bashkia Lushnjë sipas tabelës së mëposhtme:

Viti i parashikuar		**2026**	**2027**
Vlera totale e investimit	82,454,199.14 lekë		
Financimi nga AKMC	65,963,359.53 lekë	29,683,511.79 lekë	36,279,847.74 lekë
Bashkëfinancimi nga Bashkia Lushnjë	16,490,839.88 lekë	16,490,839.88 lekë	-

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Konc. Ark. Alban Manoku

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit
Ing. Ariola Beqo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr 5742 Prot.

Lushnjë, më 16/06/2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 48 DATË 16/06/2026

" PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT: REHABILITIMI I KANALIT TË UJRAVE TË LARTA (POZICIONUAR NË SEGMENTE TË NDRYSHME) DHE NDËRTIMI I MURIT MBAJTËS (ME PILOTA) NË RRUGËN " VËLLEZËRIT FRASHËRI "

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë , në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja " b ", pika 1.6 shkronja " a ", neni 23 pika 4 të Ligjit nr. 139/2015, " Për vetëqeverisjen vendore ", i ndryshuar. Neni 1 shkronja " b " neni 4 pika 1 neni 12 pika 1 të ligjit nr. 107/2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit " i përditësuar . Neni 4 pika 4, neni 6 shkronja " b ", neni 7 pika 1 të Ligjit nr. 68/2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " Ju:

PROPOZOJMË

1. Miratimin e investimit me objekt: Rehabilitimi i kanalit të ujrave të larta (pozicionuar në segmente të ndryshme) dhe ndërtimi i murit mbajtës (me pilota) në rrugën " Vëllezërit Frashëri "
2. Miratimin e vlerës totale të investimit në shumën 82,454,199.14 lek , ku vlera e investimit nga AKMC do jetë në shumën totale 65,963,359.35 lek, për vitin 2026 shuma e investimit do jetë 29,683,511.79 lek, dhe për vitin 2027 shuma e investimit do jetë 36,279,847.74 lek dhe bashkëfinancimi nga Bashkia Lushnjë është në vlerën 16,490,839.88 lek për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit, Drejtoria e Finacës dhe Buxhetit,Drejtoria Juridike dhe Prokurorimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE Bedri Hida

DREJTORIA E FINANËS Ervi a Çuko

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT Ariola Beqo

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJË

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com